www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2024 – Numri: 83

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 14 maj 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 43/2024, datë 2.5.2024	Për miratimin e dekretit nr. 295, datë 24.10.2023, "Për kthimin e ligjit nr. 77/2023, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 113/2020, 'Për shtetësinë""	9787
Vendim i Kuvendit nr. 44/2024, datë 2.5.2024	Për zgjedhjen e zotit Petrit Ahmeti kryetar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)	9787
Vendim i Kuvendit nr. 45/2024, datë 2.5.2024	Për zgjedhjen e zotit Maksim Shuli anëtar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)	9787
Dekret i Presidentit nr. 171, datë 9.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	9787
Dekret i Presidentit nr. 172, datë 9.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	9788
Dekret i Presidentit nr. 173, datë 9.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	9788
Dekret i Presidentit nr. 174, datë 9.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	9788
Dekret i Presidentit nr. 175, datë 9.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	9789
Dekret i Presidentit nr. 176, datë 9.5.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	9789
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 10, datë 26.4.2024	Për përcaktimin e procedurës për marrjen e mostrave dhe transportin e tyre për kryerjen e analizave në laborator	9789

Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 11, datë 8.5.2024	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 17, datë 24.9.2021, "Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike"	9795
Udhëzim i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 788, datë 30.4.2024	Për miratimin e modeleve të akteve në zbatim të pikës 32 të VKM-së nr. 1189, datë 24.12.2020.....	9796
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 97, datë 7.5.2024	Për delegim kompetence.....	9799
Urdhër i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar nr. 164, datë 3.5.2024	Për delegim të përkohshëm të kompetencave.....	9799
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 311, datë 3.5.2024	Për delegimin e kompetencës për trajtimin e çështjeve konsullore.....	9799
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 4.4.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-734, datë 7.3.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	9801
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 11.4.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 23/8, datë 19.1.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	9810
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7233, datë 8.5.2024	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	9817
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7234, datë 8.5.2024	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	9817
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 29, datë 8.5.2024	Për disa ndryshime në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave".....	9818
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Mereme Doda.....	9819

VENDIM
Nr. 43/2024

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT NR. 295, DATË 24.10.2023, "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 77/2023, 'PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 113/2020, 'PËR SHTETËSINË'"

Në mbështetje të nenit 85 të Kushtetutës dhe nenit 86 të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit nr. 295, datë 24.10.2023, "Për kthimin e ligjit nr. 77/2023, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 113/2020, 'Për shtetësinë'".
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 2.5.2024.

VENDIM
Nr. 44/2024

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT PETRIT AHMETI KRYETAR I BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 11 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 55 dhe nenit 111 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Petrit Ahmeti zgjidhet kryetar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 2.5.2024.

VENDIM
Nr. 45/2024

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT MAKSIM SHULI ANËTAR I BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 11 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 55 dhe nenit 111 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Maksim Shuli zgjidhet anëtar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 2.5.2024.

DEKRET
Nr. 171, datë 9.5.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Zhuljeta Stavro Grabova (Kapurani)
2. Laura Bep Pjetri
3. Rolanda Jusuf Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 172, datë 9.5.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Lulzim Memetsurja Imeri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 173, datë 9.5.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Genc Ilir Berisha
2. Ernis Shkelzen Meshi
3. Valon Sadri Lala
4. Edona Kujtim Cërvadiku (Shala)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 174, datë 9.5.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Gegë Astrit Kryeziu
2. Burbuqe Shkelzen Kryeziu (Begolli)
3. Kriton Gazmend Begolli
4. Shqiptar Hysen Ibra
5. Munir Mexhit Erebara

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 175, datë 9.5.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Lindita Ismail Hoti
2. Vlora Astrit Kryeziu Merxha
3. Skender Mehmet Muja
4. Muhamet Arif Berisha
5. Arsim Mehmet Muja
6. Shega Mexhait Erebara

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 176, datë 9.5.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Ali Rrustem Hoti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 10, datë 26.4.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E MOSTRAVE DHE TRANSPORTIN E TYRE PËR KRYERJEN E ANALIZAVE NË LABORATOR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 4, të nenit 44, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton procedurën për marrjen e mostrave për kryerjen e analizave laboratorike zyrtare të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe procedurën e transportit të tyre në laboratorin e referencës.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të ndryshuar.

Për efekt të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Loti farës" është një sasi e caktuar e farës e cila është fizikisht uniforme dhe e identifikueshme;

b) "Nënlot" është një pjesë e jo më pak se 20% e sasisë së farës, me përjashtim të një grupi farash *solanum lycopersicum* L, që është jo më pak se 5% e sasisë origjinale të farës. Çdo mbajtës i një nënloti duhet të shënohet me identifikimin e lotit të farës;

c) "Mostra primare" është një pjesë e marrë nga grupi i farës gjatë një veprimi të vetëm kampionimi;

ç) "Mostra e përbërë", mostra e cila formohet duke kombinuar dhe përzier të gjitha mostrat primare të marra nga loti i farës;

d) "Nënmostra" një nënmostër është një pjesë e një mostre të marrë, duke e reduktuar atë në një kampion të zvogëluar;

dh) "Mostra e dorëzuar" është mostra, që do të dorëzohet në laboratorin e testimit dhe mund të përmbajë ose të gjithë mostrën e përbërë ose një nënmostrim të tij. Mostra e dorëzuar mund të ndahet në nënmostra të paketuara me materiale të ndryshme, që plotësojnë kushtet për teste specifike (p.sh. lagështie ose shëndeti);

e) "Mostra e dyfishtë" është një mostër tjetër, e cila është përftuar nga e njëjta mostër e përbërë me shënimin "Mostër e dyfishtë";

ë) "Mostra e punës" është e gjithë mostra ose nënmostra e dorëzuar, mbi të cilin do të kryhet një nga analizat e cilësisë të bazuara në rregullat e ISTA, si dhe pesha e përcaktuar duhet të jetë sipas rregullave të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, në zbatim të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të ndryshuar, për analizën e caktuar;

f) "E vulosur" nënkupton paketimin në të cilën mbahet fara, i cili është i mbyllur në mënyrë të tillë që nëse hapet të jetë i pamundur të rimbyllet përsëri dhe të jetë i padëmtuar pa lënë prova të ndërhyrjes në paketim;

g) "E shënuar/etiketuar", një enë mbajtëse e një grupi fare mund të konsiderohet si e shënuar ose e etiketuar, kur ka një shenjë unike identifikimi në enë, e cila përcakton sasinë e farës së cilës i përket enës mbajtëse. Të gjitha enët mbajtëse të një grupi farërash duhet të shënohen me të njëjtin emërtim unik të grupit të farës (numra, karaktere ose kombinim i të dyjave). Nëse shenja unike e identifikimit tregohet në një etiketë të bashkangjitur në enë, nuk duhet të jetë e mundur të hiqet etiketa dhe të zëvendësohet me një etiketë tjetër pa shfaqur shenja ndërhyrjeje. Shënimi i mostrave dhe nënmostrave duhet të sigurojë, që të ketë gjithmonë një lidhje të qartë midis grupit të farës dhe mostrave, dhe nënmostrave;

gj) "Fara e trajtuar" është loti i farës, të cilit i nënshtrohet:

a) një aplikim me PMB, ngjyrues identifikues, ngjyra dhe/ose aditivë të tjerë;

b) aplikimi i një produkti biologjik, duke përfshirë mikroorganizma;

c) një proces që përfshin njomjen dhe tharjen;

d) një formë energjie duke përfshirë nxehtësinë, rrezatimin, elektricitetin ose magnetizmin, por nuk specifikon mënyrën e aplikimit;

h) "Farat e veshura", farat e veshura janë fara të mbuluara me material, në mënyrë të tillë që në shumicën e rasteve farat nuk mund të identifikohen pa hequr materialin mbulues. Materiali mund të përmbajë pesticide, fungicide, biologjikë, ngjyrues identifikues, ngjyra dhe/ose aditivë të tjerë.

Llojet e farave të veshura janë të përcaktuara si më poshtë:

i. Farë e peletuar është njësi sferike, që përfshinë një farë të vetme, ku madhësia dhe forma e farës nuk janë më të dukshme;

ii. Farë e mbështjellë është fara që ruan kryesisht formën, madhësinë dhe peshën e farës me ndryshime në një masë të matshme;

iii. Farë granulare është fara me formë kryesisht cilindrike, duke përfshirë më shumë se një farë për granulë;

iv. Fara në shirita janë fara të vendosura në mënyrë të rastësishme, në grupe ose në një rresht të vetëm, në shirita të ngushtë me material letre ose materiale të tjera të degradueshme;

v. Fara në shtroje janë fara të vendosura në rreshta, grupe ose në mënyrë të rastësishme në shtroje të gjera, me material letre, ose materiale të tjera të degradueshme;

i. "Sasi të vogla të lotit të farës" janë sasi të vogla fare të një cilësie të lartë të lotit të farës, ku marrja e një mostre të dorëzuar me madhësi standard mund të ketë një efekt thelbësor në sasinë e pjesës së mbetur të farës. Në farat me cilësi të lartë përfshihen farat e hibrideve të perimeve, të cilat shiten si fara për treg, ose për farat të cilat nuk janë akoma të tregtueshme, por që përdoren për qëllime kërkimore për të prodhuar fara për shumëzim të hallkave të larta;

j) "Enë mbajtëse" është çdo formë ambalazhi si: paketa prej letre ose plastike, thasë, enë aluminate cilindrike, bustina etj., të cilat shërbejnë për marrjen dhe transportin e farave për analizim;

k) "Sondë kampionimi" është instrument në formë tubi të gjatë cilindrik me majë, që shërben për marrjen e mostrave të farave. Ato janë me dimensione të ndryshme dhe përdoren me qëllim përftimin e të gjitha llojeve të farave gjatë një procesi për marrjen e mostrave. Në varësi të ambalazhit të

farës përdoren sondat e përshtatshme për të përftuar një mostër fare sa më konforme.

3. Mostra e marrë për analizim duhet të jetë e një madhësie të përshtatshme për të kryer analizën, në të cilën mundësia e pranisë së një përbërësi përcaktohet vetëm nga niveli i paraqitjes së tij në lotin e farës.

4. Kushtet për marrjen e mostrave në një lot fare janë si më poshtë:

a) Në momentin e marrjes së mostrës, sasia e farës duhet të jetë sa më uniforme të jetë e mundur.

Nëse sasia e farës rezulton se është dukshëm heterogjene, marrja e mostrave duhet të refuzohet ose të ndërpritet;

b) Mostra e farës për analizim merret, si për rastet kur ato janë rifuxho, si dhe në rastin kur janë të ambalazhuara;

c) Enët mbajtëse në të cilët mbahen farat duhet të jenë të përshtatshme, me qëllim mosdëmtimin e farës, të pastra për të shmangur ndotjen e kryqëzuar. Enët mbajtëse duhet të etiketohen ose të shënjohen përpara, ose menjëherë pas përfundimit të mostrimit;

ç) Loti i farës duhet të jetë i vendosur në mënyrë të tillë për të qenë lehtësisht i aksesueshëm.

5. Intensiteti minimal i mostrimit për grupet e farave në ambalazhe, që përmbajnë deri në 100 kg, është si më poshtë:

a) Për ambalazhet që mbajnë nga 15 kg deri në 100 kg farë, numri i mostrave parësore është sipas tabelës 2.A, në shtojcën 1,që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

b) Për ambalazhet që mbajnë më pak se 15 kg farë, ambalazhet duhet të kombinohen në njësi kampionimi që nuk i kalojnë 100 kg dhe konkretisht: 20 ambalazhe x 5 kg, 33 ambalazhe x 3 kg ose 100 ambalazhe x 1 kg. Njësitë e mostrimit duhet të konsiderohen, siç janë përshkruar në tabelën 2.A në shtojcën 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

c) Për kategoritë e farave të peletuara, farat granulare, farat në shirita dhe farat në shtroje, ambalazhet me më pak se 300 000 njësi farash duhet të kombinohen me njësitë e mostrimit, që nuk i kalojnë 2 000 000 fara. Njësitë e kampionimit duhet të konsiderohen si: ambalazhet të përshkruara në tabelën 2.A, në shtojcën 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

6. Për ambalazhet që mbajnë më shumë se 100 kg farë mostra, merret nga rrjedhja e farës dhe intensiteti i marrjes së mostrës bëhet sipas tabelës 2.B, në shtojcën 2, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, e cila duhet të konsiderohet sasi minimale.

7. Gjatë marrjes së mostrave të një loti fare deri në 15 ambalazhe, pavarësisht nga madhësia e tyre, duhet të merret i njëjti numër mostrash parësore nga çdo ambalazh.

Intensiteti i marrjes së mostrave për farat e veshura është siç përshkruhet në tabelat 2.A dhe 2.B, në shtojcat 1 dhe 2, që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

8. Procedura për marrjen e mostrave primare:

a) Në rastet kur është përcaktuar numri dhe/ose madhësia e mostrave primare, marrësi i mostrës së farës duhet të sigurojë (përmbushjen e intensitetit minimal të kampionimit), sasinë minimale të farës për analizimin e kërkuar, e cila dërgohet në laboratorin e analizimit dhe të ketë farë të mjaftueshme edhe për marrjen e mostrave të dyfishta nëse kërkohet:

i. mostrat primare me përmasa afërsisht të barabarta duhet të merren nga i njëjti lot i farës;

ii. kur sasia e farës është e ambalazhuar, ambalazhet që do të mostrohen duhet të zgjidhen në mënyrë të rastësishme, në të gjithë lotin e farës. Mostrat primare duhet të merren nga sipër, mesi dhe fundi i ambalazheve, por jo domosdoshmërish nga më shumë se një pozicion në çdo ambalazh, përveç rasteve kur specifikohet në tabelat 2.A dhe 2.B, në shtojcat 1 dhe 2, që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse të këtij udhëzimi;

iii. kur fara është me shumicë ose në ambalazhe të mëdhenj, mostrat parësore duhet të merren nga pozicione të rastësishme. Ambalazhet duhet të hapen ose shpohen për nxjerrjen e mostrave parësore. Ambalazhet e kampionuar më pas duhet të mbyllen ose fara duhet të transferohet në ambalazhe të rinj;

iv. kur fara do të paketohet në lloje të veçanta ambalazhesh (ambalazhe të vegjël, jo të depërtueshëm ose rezistent ndaj lagështirës), nëse është e mundur, kampioni duhet marrë para ose gjatë mbushjes së ambalazheve. Marrja e mostrave të loteve të farave në shirita, dhe të farave në shtroje, duhet të bëhet duke marrë pako ose copa shiriti ose shtrojet;

v. instrumentet që përdoren për marrjen e mostrave nuk duhet të dëmtojnë farën dhe as të zgjedhin sipas madhësisë, formës, dendësisë, ose

ndonjë veçorie tjetër cilësore. Të gjitha aparatet e marrjes së mostrave duhet të jenë të pastra përpara përdorimit për të parandaluar ndotjet e kryqëzuara. Sonda duhet të jetë mjaftueshëm e gjatë, në mënyrë që maja e saj të arrijë të paktën gjysmën e diametrit të ambalazhit.

9. Procedura për marrjen e mostrave të lotit të farave bëhet me një nga metodat e përcaktuara më poshtë:

a) Për marrjen e mostrës rifuxho përdoren pajisje manuale ose automatike. Intervalet ndërmjet marrjes së mostrave parësore duhet të jenë konstante. Fara rifuxho merret me pajisje automatike të marrjes së mostrave, me kusht që instrumenti të mostrojë në mënyrë uniforme seksionin kryq të rrjedhës së farës dhe farat që hyjnë në instrument të mos dalin përsëri jashtë;

b) Marrja e mostrave manuale (rifuxho). Rrjedhat e farave mund të merren gjithashtu duke përdorur instrumente manuale, kur plotësohen kërkesat e renditura në pikën "a";

c) Marrja e mostrave me dorë. Kjo metodë është e përshtatshme për të gjitha speciet dhe farat që mund të dëmtohen nga përdorimi i sondave, siç janë fara me krahë, fara me përmbajtje të ulët lagështie, fara në shirita dhe farat në shtroje. Për marrjen e mostrave të farës me dorë duhet të jetë e aksesueshme marrja e saj në të gjitha pozicionet në ambalazhet ku ajo ndodhet. Në rastet e ambalazheve të mbyllura dhe ku nuk është e mundur hapja e rregullt duhet të priten, të merren mostra dhe më pas të ripaketohen;

ç) Procedura për marrjen e mostrës së përbërë. Kur është e mundur, mostrat primare krahasohen me njëra-tjetrën gjatë marrjes së mostrave. Mostrat parësore mund të kombinohen për të formuar mostrën e përbërë vetëm nëse ato duken të njëtrajtshme. Nëse jo, procedura e marrjes së mostrave duhet të ndërpritet. Kur mostrat primare mblidhen direkt në një enë, përmbajtja e këtij mbajtësi mund të konsiderohet si mostër e përbërë vetëm nëse duket uniforme. Nëse jo, nuk duhet të përdoret për marrjen e mostrës së dorëzuar;

d) Mostra e përbërë mund të dorëzohet në laboratorin e analizimit të farës nëse është e madhësisë së duhur për analizat që do të kryhen ose nëse është e vështirë të përzihet dhe të zvogëlohet mostra e përbërë, siç kërkohet në kushtet e laboratorit;

dh) Nëse mostra e përbërë, e dorëzuar për të gjitha analizat, është shumë e madhe, mostra e dorëzuar duhet të merret duke reduktuar mostrën e përbërë në një madhësi të përshtatshme me një nga metodat e përmendura më lart;

e) Marrja e mostrave të dorëzuara në madhësinë e kërkuar për testimin e lagështisë duhet të kryhet, në mënyrë të tillë që ndryshimet në përmbajtjen e lagështisë të jenë minimale;

Mostrat duhet të merren në këtë mënyrë nga mostra e përbërë: së pari, përzien mostrën e përbërë ose duke e trazuar, ose duke e kaluar nëpër një ndarës mekanik dhe duke e kombinuar mundësisht një herë, por jo më shumë se tre herë. Më pas, merret një minimum prej tre nënmostrash nga pozicione të ndryshme dhe kombinohen për të krijuar mostrën e dorëzuar për testimin e lagështisë;

ë) Mostrat e dyfishta, të cilat janë kërkuar jo më vonë se në momentin e marrjes së mostrës, duhet të përgatiten në të njëjtën mënyrë si mostra e dorëzuar.

10. Paketimi dhe dërgimi i mostrës së dorëzuar.

a) Mostra e dorëzuar duhet të shënohet me të njëjtin identifikim si loti i farës. Duhet të jepet informacioni shtesë, i kërkuar sipas shkronjës "dh", të pikës 2, si dhe emri i çdo trajtimi kimik të aplikuar. Mostrat e dorëzuara duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohen dëmtimet gjatë transportit dhe të paketohen në mbajtës të ajrosur;

b) Mostrat e dorëzuara për testimin e lagështisë dhe mostrat nga grupet e farave të cilat janë tharë deri në përmbajtje të ulët lagështie, duhet të paketohen në enë rezistente ndaj lagështirës, që përmbajnë sa më pak ajër të jetë e mundur;

c) Mostrat e dorëzuara për analizat e fuqisë mbirëse, analizat për energji mbirëse dhe testet e shëndetit të farës mund të paketohen vetëm në ambalazhe të papërshkueshme nga lagështira, duke siguruar kushte të përshtatshme magazinimi;

d) Mostrat e dorëzuara duhet të dërgohen në laboratorin e testimit të farës pa vonesë;

e) Modeli i etiketës që shoqëron mostrën për kontroll zyrtar, përpara dërgimit të kodifikuar për analizim në laborator, është sipas shtojcës 5, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

f) Modeli i etiketës që shoqëron mostrën për procedurën e certifikimit zyrtar dhe dërgimin për analizim në laborator, është sipas shtojcës 6, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

12. Dorëzimi i mostrës në laborator:

a) Mostra e farës për analizë zyrtare dërgohet e kodifikuar dhe dorëzohet në zyrën pritëse të mostrave, më pas punonjësi përgjegjës bën kodifikimin e tyre dhe i dërgon në laboratorin përkatës. Mostra pasi regjistrohet në regjistrin e pranimit të mostrave, kodifikohet dhe dorëzohet për analizim. Pasi regjistrohet në regjistrin e pranimit të mostrave i dorëzohet laboratorit, e kodifikuar, me qëllim ruajtjen e anonimatit;

b) Mostra e farës për laborator është e ambalazhuar në material prej letre ose plastike, e miratuar nga ESHFF-ja, e mbushur deri në 2/3 e volumit të saj, e mbyllur dhe e vulosur nga personi i ngarkuar për marrjen e mostrës;

c) Mostrës së farës që dërgohet në laborator i vihet brenda etiketa përkatëse;

d) Mostrat e farës që dorëzohen në laborator pranohen kur ato janë të rregullta në ambalazh, masë, dokumentacion mbylljeje dhe kur paraqiten brenda 24 orëve. Në rast mosplotësimi të kritereve më lart, mostrat konsiderohen të parregullta dhe nuk pranohen nga laboratori;

e) Madhësia e lotit të farës dhe pesha minimale e mostrës së marrë nga loti janë sipas akteve nënligjore në fuqi, në zbatim të ligjit nr. 10416 datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të ndryshuar.

13. Tolerancat e pastërtisë dhe të mbirjes së deklaruar në etiketën e prodhuesit, dhe ato të analizuara zyrtarisht, janë sipas tabelave 3.A dhe 3.B, në shtojcat 3 dhe 4, që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

14. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Enti Shtetëror i Fara Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

Shtojca 1

Tabela 2.A: Intensiteti minimal i marrjes së mostrave për lotet e farërave në ambalazhe, që mbajnë deri në 100 kg farë

Numri i ambalazheve	Numri minimal i mostrave primare që duhen marrë
1–4	3 mostra primare nga secili mbajtës
5–8	2 mostra primare nga secili mbajtës
9–15	1 mostër primare nga secili mbajtës
16–30	15 mostra primare, nga një mostër nga 15 mbajtës të ndryshëm
31–59	20 mostra primare, nga një mostër nga 20 mbajtës të ndryshëm
60 ose më shumë	30 mostra primare, nga një mostër nga 30 mbajtës të ndryshëm

Shtojca 2

Tabela 2.B: Numri minimal i mostrave primare që duhet të merren nga grupet e farave në ambalazhe, që mbajnë më shumë se 100 kg farë ose nga rrjedhat e farave (rifuxho)

Sasia e lotit të farës	Numri i mostrave primare që do të merren
Deri në 500 kg	Të paktën 5 mostra primare
501–3000 kg	1 mostër primare për çdo 300 kg, por jo më pak se 5 mostra primare
3001–20000 kg	1 mostër primare për çdo 500 kg, por jo më pak se 10 mostra primare
20001 kg dhe më shumë	1 mostër primare për çdo 700 kg, por jo më pak se 40 mostra primare

Shtojca 3

Tabela 3.A: Përqindja e mbirjes

Përqindja e mbirjes e deklaruar nga prodhuesi	Toleranca në përqindje në raport me analizën zyrtare
100/99	1
98/96	2
95/92	3
91/88	4

87/80	5
79/71	6
70/60	7
59/50	8

Shtojca 4

Tabela 3.B: Përqindja e pastërtisë

Përqindja e pastërtisë së deklaruar nga prodhuesi	Toleranca në përqindje në raport me analizën zyrtare
100	0.8
99	1
98	1.2
97	1.3
96	1.4
95	1.5
94	1.6
93	1.7
92	1.9
91/90	2
89/85	2.5
84/80	3.5
79/75	3.5

Shtojca 5

Përmbajtja e etiketës për marrjen e mostrave për certifikim zyrtar

Nr. kodit .....
Lloji i analizës .....
Specia .....
Varieteti .....
Kategoria .....
Viti i prodhimit .....
Analizë zyrtare/private .....
Emri i kodifikuesit .....

Shtojca 6

Përmbajtja e etiketës për kontroll zyrtar

Nr. ……, datë ……
Emri i subjektit …….
Kultura …….
Varieteti ……
Riprodhimi ……
Viti i prodhimit …….
Kontigjenti nr. (loti) ……..
Pesha e kontigjentit kv ……..
Nr. i vendeve nga merret kampioni ……..
Analiza që do t'i bëhet farës …….
Nr. i lotit …….

UDHËZIM
Nr. 11, datë 8.5.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 24.9.2021, "PËR KËRKESAT SPECIFIKE TË HIGJIENËS PËR MISHIN DHE PRODUKTET E MISHIT, DUKE PËRFSHIRË PRODUKTET E MISHIT, MISHIN E GRIRË DHE MISHIN E NDARË NË MËNYRË MEKANIKE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar, dhe të neneve 131 dhe 132, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 17, datë 24.9.2021, "Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike", bëhet ndryshimi si vijon:

1. Shtojca VIII zëvendësohet me shtojcën VIII/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe bëhet pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

ANEKSI VIII/1

AKVMB
AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

REGJISTRI I THERTORES MUAJI_____Fleta Nr.

Nr.	Data e/ora e mbërritjes	Nr. i krerëve / specia	Nr. i certifikatës veterinare	Nr. matrikull/ kodi i fermës	Data/ora e therjes			Konstatime shëndetësore	Të konfiskuara	Nr. i certifikatës veterinare të karkasës	Pesha në kg e karkasës pas maturimit	Emri i sub. tregtar(1)	Data e daljes(2)	Pesha në kg e lëkurëve dhe/ose produkteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor	Nr. i certifikatës veterinare që shoqëron ngarkesën e lëkurëve dhe/ose produkteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor	Data e daljes	Emri i sub. tregtar tek i cili dërgohen
					Kontroll/ para therjes	Kontroll/ gjatë therjes	Kontroll pas therjes										

1. Plotësohet nga operatori i biznesit ushqimor të thertores.
2. Plotësohet nga operatori i biznesit ushqimor të thertores.

UDHËZIM
Nr. 788, datë 30.4.2024

PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË AKTEVE NË ZBATIM TË PIKËS 32 TË VKM-së NR. 1189, DATË 24.12.2020

Në mbështetje të germës "ç", të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", germës "c", të nenit 9 të ligjit nr. 111/2018, "Për Kadastrën", si dhe në zbatim të pikës 32 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1189, datë 24.12.2020, "Për rregullat e hollësishme për kalimin e pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluara, afatet dhe mënyra e llogaritjes dhe njoftimit të pagesës, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë në zonat e stimuluara",

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë modelet dhe përmbajtjen e akteve të dala në zbatim të procedurës të nenit 51 të ligjit 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe pikës 10.1 dhe 10.2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1189, datë 24.12.2020, "Për rregullat e hollësishme për kalimin e pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluara, afatet dhe mënyra e llogaritjes dhe njoftimit të pagesës, zbritjet që përfitohen si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë në zonat e stimuluara".

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Procesverbal dorëzimi i njësisë ndërtimore", është akti që hartohet në funksion të përmbushjes së detyrimit të dorëzimit vullnetar sipas afatit të përcaktuar, të njësisë ndërtimore nga personi i stimuluar/subjekti i interesuar tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

b) "Urdhër për dorëzim të detyruar", është akti që hartohet nga ASHK-ja në funksion të dorëzimit të njësisë ndërtimore nga personi i stimuluar/ subjekti i interesuar tek ASHK-ja, në rastet e mospërmbushjes së dorëzimit vullnetar të kësaj njësie prej tij, sipas njoftimit nga ASHK-ja dhe afatit të parashikuar.

II. MODELET E AKTEVE "PROCES-VERBAL DORËZIMI I NJËSISË NDËRTI-MORE" DHE "URDHËR PËR DORËZIM TË DETYRUAR"

1. ASHK në vijim dhe zbatim të procedurës të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe pikës 10, 10.1 dhe 10.2 të VKM-së nr. 1189/2020, "Për rregullat e hollësishme për kalimin e pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluara, afatet dhe mënyra e llogaritjes dhe njoftimit të pagesës, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë në zonat e stimuluara " harton aktet sa vijon:

a) procesverbal dorëzimi i njësisë ndërtimore;

b) urdhër për dorëzim të detyruar.

2. Procesverbali i dorëzimit të njësisë ndërtimore, është sipas Aneksit 1 që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Ky akt është pjesë e praktikës administrative të vendimmarrjes të ASHK-së në vijim të procedurës së pikës 10 të VKM-së nr. 1189/2020, dhe administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat.

3. Procesverbal i dorëzimit të njësisë ndërtimore ka në përmbajtje të dhënat si vijon:

a) numrin e protokollit dhe datën që merr akti kur zyrtarizohet;

b) bazën ligjore për nxjerrjen e aktit, të dhënat identifikuese të momentit kur kryhet procesverbali (datë/muaj/vit/orën) dhe të dhënat e njoftimit drejtuar personit të stimuluar/subjektit të interesuar;

c) të dhënat identifikuese të njësisë ndërtimore;

d) gjeneralitetet dhe të dhënat identifikuese të personit të stimuluar/ subjektit të interesuar dhe përfaqësuesit të ASHK-së;

e) përshkrimin e veprimeve që kryhen nga personi i stimuluar/subjekti i interesuar dhe përfaqësuesi i ASHK-së në funksion të përmbushjes së detyrimit të dorëzimit vullnetar të njësisë ndërtimore;

f) rubrikën me gjeneralitetet dhe nënshkrimin e personit të stimuluar/subjektit të interesuar dhe përfaqësuesit të ASHK-së.

4. Urdhri për dorëzim të detyruar, është sipas aneksit 2 që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Ai hartohet e miratohet në format digjital, dhe një kopje e printuar administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat.

5. Urdhri për dorëzim të detyruar ka në përmbajtje të dhënat si vijon:

a) numrin e protokollit dhe datën që merr akti kur zyrtarizohet;

b) gjeneralitetet dhe të dhënat identifikuese të personit të stimuluar/subjektit të interesuar dhe të dhënat e vendit/adresës ku i bëhet komunikimi i njoftimit zyrtarisht;

c) bazën ligjore për nxjerrjen e aktit;

ç) përshkrimin e rrethanave dhe fakteve mbi veprimet e kryera dhe të konstatuara lidhur me njësinë ndërtimore(*të dhënat e njësisë ndërtimore, të dhënat e njoftimit për dorëzimin vullnetar të saj nga personi i stimuluar/subjekti i interesuar dhe evidentimin e faktit të mosdorëzimit vullnetar të saj*);

d) dispozitivin ku parashikohet detyrimi për dorëzimin e njësisë ndërtimore nga personi i stimuluar/subjekti i interesuar, afati i parashikuar për dorëzimin e tij, si dhe faktin se ky akt përbën titull ekzekutiv;

e) gjeneralitetet, nënshkrimin e titullarit dhe vula e drejtorisë vendore të ASHK-së.

6. Ngarkohen drejtoritë vendore të ASHK-së për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dallëndyshe Bici

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(ANEKSI 1)

Nr._____Prot Tiranë, më __.__.__

PROCESVERBAL
(dorëzimi i njësisë ndërtimore)

Në zbatim të nenit 51 të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe pikës 10, 10.1 të VKM nr.1189/2020 "Për rregullat e hollësishme për kalimin e pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluara, afatet dhe mënyra e llogaritjes dhe njoftimit të pagesës, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë në zonat e stimuluara":

Sot, në datë____, (muaji)____, (viti)_____, ora_____, në vendin e quajtur (adresa e saktë)_____, pas njoftimit të personit të stimuluar/subjektit të interesuar _____ me shkresën nr._____ prot., datë ____/____/_____ për dorëzimin e njësisë ndërtimore, mbahet proceseverbali i mëposhtëm mbi dorëzimin e Njësisë Ndërtimore_____(përshkrimi), legalizuar me vendimin nr._____, datë _____ /_____/_____/ dhe regjistruar në regjistrin kadastral me nr._____, ZK _____, drejtoria vendore e ASHK-së _____, ndërmjet:

Personit të stimuluar/ Subjektit të interesuar: 1._____
2._____.....dhe

Përfaqësuesit të ASHK-së: 1._____
2._____

Nga personi i stimuluar/personi i interesuar parashtrohet se u hoqën nga njësia ndërtimore sendet e luajtshme dhe u dorëzua vullnetarisht e lirë kjo njësi tek ASHK :_____

Nga përfaqësuesi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës parashtrohet se u mor në dorëzim njësia ndërtimore dhe aksesi i saj nga drejtoria vendore e ASHK-së _____ në të

Procesi i marrjes në dorëzim të njësisë ndërtimore përfundon në orën_____.

Procesverbali mbyllet dhe pasi lexohet, kuptohet prej secilit pjesëmarrës të tij, nënshkruhet prej tyre pa asnjë kontestim, apo vërejtje. Ky procesverbal mbahet në 3 kopje origjinale, ku një kopje i dorëzohet personit të stimuluar/subjektit të interesuar, dhe 2 kopje i mbeten ASHK-së.

Procesverbali lexohet dhe nënshkruhet rregullisht nga të pranishmit.

PERSONI I STIMULUAR/ SUBJEKTI I INTERESUAR **PËRFAQËSUESI I ASHK-SË**

_____ _____

MODEL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS (*ANEKSI 2*)
DREJTORIA VENDORE E ASHK-SË _____

Nr_____Prot **Datë ___/___/__**

URDHËR
"Për dorëzim të detyruar "

Drejtuar: Personit të stimuluar/Subjektit të interesuar_____
Adresa:_____

Në zbatim të nenit 51 të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", pikës 10.2 të VKM nr.1189/2020 "Për rregullat e hollësishme për kalimin e pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluara, afatet dhe mënyra e llogaritjes dhe njoftimit të pagesës, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë në zonat e stimuluara" dhe në vijim të shkresës tonë nr..... prot., datë ___/___/____ për dorëzimin vullnetar të njësisë ndërtimore_____ *(të dhënat e njësisë*),

KONSTATOVA:

Me vendimin nr._____, datë _/___/_____ të drejtorisë vendore të ASHK-së _____ njësia ndërtimore është legalizuar në favor të shtetit dhe është regjistruar në regjistrat kadastral me nr._____, ZK_____.
Me shkresën nr._____ prot., datë ___/___/___ jeni njoftuar për dorëzimin vullnetar të kësaj njësie ndërtimore brenda 30(tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e njoftimit.
Në kushtet kur nga ana juaj nuk është përmbushur detyrimi për dorëzimin vullnetar të njësisë ndërtimore të sipërcituar sipas afatit ligjor të sipërcituar, përsa më sipër në referim të pikës 10.2 të VKM nr.1189/2020 "Për rregullat e hollësishme për kalimin e pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluara, afatet dhe mënyra e llogaritjes dhe njoftimit të pagesës, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë në zonat e stimuluara",

URDHËROJ

-Dorëzimin e njësisë ndërtimore _____(*të dhënat e njësisë*) nga ana e personit të stimuluar/subjektit të interesuar _____ tek ASHK, brenda 5(pesë) ditëve nga marrja dijeni e njoftimit.
-Në rast mospërmbushje të detyrimit nga ana juaj sipas afatit të sipërcituar, ky akt përbën titull ekzekutiv.

DREJTOR

_____

(emër, mbiemër, nënshkrimi , vula e institucionit)

Ky urdher hartohet ne 3 kopje

URDHËR
Nr. 97, datë 7.5.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të ligjit nr. 111/2015, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë për miratimin e Programit Zhvillimor të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për vitin 2024, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 164, datë 3.5.2024

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, "Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar", nenit 26, të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, "Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave, të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit, z. Enton Sadiku.
2. Z. Enton Sadiku i delegohen kompetencat si më poshtë:
   - ndjek dhe zbaton "Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar" (i ndryshuar);
   - ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-ut;
   - ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;
   - merr dhe trajton korrespondencën shkresore.
3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 7.5.2024 deri më 9.5.2024.
4. Z. Enton Sadiku nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit.
6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.
7. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, një për Protokoll-Arkivin, një për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe një për drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Altin Jani

URDHËR
Nr. 311, datë 3.5.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR TRAJTIMIN E ÇËSHTJEVE KONSULLORE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së", nenet 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së

Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 8372, datë 9.7.1998, "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore", ligjin nr. 90/2012, "Për administratën publike",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për trajtimin e çështjeve konsullore te Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

2. Sekretari i Përgjithshëm ngarkohet për nënshkrimin e akteve me karakter konsullor që nuk përfshihen në paragrafin 4 (katër) të këtij urdhri.

3. Sekretaria Qendrore qarkullon kundrejt nënshkrimit te drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore dokumentet hyrëse në institucion me karakter të qartë konsullor. Rastet e tjera qarkullohen sipas rregullit të përgjithshëm të dokumenteve hyrëse.

4. Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore është personi përgjegjës për nënshkrimin e akteve vijuese:

a) përcjellje e akteve të gjendjes civile, lejeve të drejtimit, pasaportave, sendeve të humbura, specimene të dokumenteve shqiptarë apo të huaj;

b) verifikim dokumentacioni (të lëshuara nga institucionet shqiptare), identiteti për shtetasit shqiptarë, figurë për kandidatët për konsuj nderi të RSH-së dhe të huaj;

c) nota verbale mbështetëse për vizë për institucionet, si edhe diplomatet e emëruar, përgjigje me karakter konsullor letrat hyrëse për shtetasit afganë;

ç) kërkesat për çelje-mbyllje aksesesh për diplomatë, operatore tek Identitek, MB-ja, MD-ja;

d) shkresa shoqëruese për postën diplomatike që përmban pasaporta materiale të identitek;

dh) përcjellje praktikash për heqjen dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare;

e) përcjellje praktikash për heqjen dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare;

ë) përcjellje kërkesash për ekstradim, ndihmë juridike, ndalim, arrestim për shtetas shqiptarë e huaj.

5. Sekretari i Përgjithshëm ngarkohet për nënshkrimin e akteve me karakter konsullor që nuk përfshihen në paragrafin 3 të këtij urdhri.

6. Njoftimet dhe komunikimet elektronike, për çështjet konsullore, i drejtohen drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore. Për çdo çështje vihet në dijeni Sekretari i Përgjithshëm.

7. Të gjitha njoftimet për çështjet konsullore, publikimi i aktiviteteve konsullore në faqet zyrtare dhe llogaritë zyrtare të rrjeteve sociale të MEPJ-së dhe të misioneve diplomatike/posteve konsullore të RSH-së bëhen me miratim të Sekretarit të Përgjithshëm, sipas propozimeve të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, në bashkëpunim me kabinetin e ministrit.

8. Titullarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë i raportojnë për veprimtarinë konsullore, në bazë ditore, drejtorit të drejtorisë që mbulon çështjet konsullore.

9. Drejtori i drejtorisë që mbulon çështjet konsullore i raporton në bazë ditore veprimtarinë konsullore të ushtruar nga përfaqësitë/postet konsullore Sekretarit të Përgjithshëm.

10. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror, Drejtoria e Çështjeve Konsullore, kabineti i ministrit, titullarët dhe punonjësit konsullorë në misionet diplomatike dhe postet konsullore të RSH-së.

11. Ngarkohen me njoftimin e këtij urdhri strukturat e institucionit dhe misionet diplomatike e konsullore, Sektori i Menaxhimit të Dokumentacionit në Drejtorinë e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

12. Urdhri i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 454, datë 31.8.2022, "Për çështjet konsullore", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani

VENDIM
Nr. 23, datë 4.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 2.4.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (B) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Bujar Musta

SUBJEKT I INTERESUAR:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, përfaqësuar nga zëvendëskryetari, Ilir Rusi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-734, datë 7.3.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, pika 3, shkronja "e", 71 dhe 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Bujar Musta ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Për shkak të paraqitjes së tre ankesave në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë *(KLD),* nga disa shtetas palë ndërgjyqëse në proceset gjyqësore në të cilat ai ka qenë gjyqtar i çështjes, ndaj tij ka filluar verifikimi i këtyre ankesave nga ana e Inspektoratit të KLD-së.

2. Pas përfundimit të verifikimit të veprimtarisë gjyqësore të kërkuesit, në lidhje me këto ankesa, KLD-ja ka hartuar relacionet me gjetjet përkatëse, duke arritur në përfundimin se kërkuesi ka lejuar zvarritje të përsëritur e të pajustifikuar të veprimeve procedurale me pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve dhe imazhin e drejtësisë. Këto relacione i janë dërguar ministrit të Drejtësisë. Ky i fundit, duke vlerësuar se shkeljet e kërkuesit parashikohen nga neni 32, pika 3, shkronja "a", i ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si raste të përgjegjësisë disiplinore në kategorinë e shkeljeve të rënda, me shkresën nr. 1105 prot., datë 12.2.2014, ka filluar procedimin disiplinor, duke kërkuar marrjen e masës disiplinore "*Dërgimin për 1–2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij*". Në seancën plenare të datës 16.7.2014, të thirrur nga KLD-ja për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj kërkuesit, ministri i Drejtësisë ka ndryshuar propozimin, duke kërkuar marrjen e një mase disiplinore më të lehtë, atë të "*Vërejtjes me paralajmërim*".

3. Në përfundim të shqyrtimit të procedimit disiplinor, me vendimin nr. 99, datë 16.7.2014, KLD-ja ka miratuar masën disiplinore të propozuar nga ministri i Drejtësisë "*Vërejtje me paralajmërim*", duke vlerësuar se shkeljet e konstatuara në veprimtarinë gjyqësore të kërkuesit kanë dëmtuar besimin e publikut në dhënien dhe administrimin e drejtësisë, duke ulur imazhin e sistemit gjyqësor, duke prekur interesat e një mase të madhe njerëzish dhe duke shkaktuar dëme për palët, në cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese. Sipas KLD-së sjellja e gjyqtarit ka diskretituar rëndë pozitën dhe figurën e tij, duke treguar dhe paaftësinë e tij për të përballuar punën e përditshme. Duke mos qenë dakord me

këtë vendim dhe duke pretenduar se KLD-ja ka vepruar në kundërshtim me ligjin, kërkuesi e ka ankimuar atë në gjykatën e apelit.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 62, datë 16.12.2014, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*, duke pasur parasysh se objekt i padisë është një vendim i organit të administratës publike (akt administrativ i KLD-së), ka deklaruar moskompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e saj Gjykatës Administrative të Apelit. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 00-2015-1946, datë 12.5.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 9, datë 15.3.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se nuk ka shkaqe për cenimin e vendimit të KLD-së. Sipas asaj gjykate veprimtaria e zhvilluar nga KLD-ja është e ligjshme dhe bazuar në aktet e pranuara për shqyrtim, ndërsa konkluzioni për dhënien e masës disiplinore është i bazuar në ligj. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.6.2016.

6. Përpara se çështja e kërkuesit të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*KPK*), me vendimin nr. 447, datë 17.9.2021, ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (*KPA*), i cili është regjistruar në datën 8.11.2021, por nga të dhënat e faqes zyrtare të atij institucioni ende nuk ka një vendim përfundimtar për të. Në kuptim të parashikimeve të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, deri në dhënien e vendimit nga KPA-ja kërkuesi është i pezulluar nga detyra por vijon të ruajë statusin e magjistratit.

7. Ndërkohë, në lidhje me rekursin e regjistruar në Gjykatën e Lartë për kundërshtimin e masës disiplinore të dhënë ndaj kërkuesit, Kolegji Administrativ i asaj gjykate, me vendimin nr. 00-2023-734, datë 7.3.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi i kërkuesit nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

8. Në datën 13.7.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 14.7.2023. Me vendimin e datës 26.7.2023 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një gjyqtari për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes dhe me vendimin e datës 21.9.2023 ka vendosur caktimin e një gjyqtari tjetër në përbërje të Kolegjit për shqyrtimin paraprak. Me vendimin e datës 5.10.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së aksesit, së drejtës së ankimit dhe asaj për t'u dëgjuar, si dhe së drejtës për mbrojtje efektive*, pasi nuk është njoftuar përmes postës elektronike për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, edhe pse ai kishte lënë të dhënat e tij të kontaktit, çka vërtetohet nga njoftimi i vendimit të asaj gjykate nëpërmjet postës elektronike. Gjykata e Lartë nuk e ka bërë njoftimin për zhvillimin e gjykimit as në faqen e saj të internetit. Ky mosnjoftim ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjes dhe në këtë mënyrë kërkuesi është vendosur në pamundësi objektive për të ushtruar lirisht, realisht dhe efektivisht të drejtat e tij

9.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike,* pasi sipas nenit 179, pika 7, fjalia e dytë, të Kushtetutës dhe nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 84/2016*), kompetenca për të marrë në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të KLGJ-së për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve është KPA-ja. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 36, datë 24.11.2022, ashtu si edhe Gjykata e Lartë në vendimin nr. 1, datë 20.1.2023 të Kolegjeve të Bashkuara të saj, ku është arritur në përfundimin se kjo e fundit nuk ka më juridiksion gjyqësor të zakonshëm për shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre, pasi ky juridiksion i ka kaluar KPA-së. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet ta dërgonte çështjen për shqyrtim te KPA-ja.

9.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* pasi Kolegji Administrativ i

Gjykatës së Lartë kishte detyrimin të verifikonte marrjen dijeni të kërkuesit për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit. Gjykata e Lartë nuk ka garantuar krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta në procesin gjyqësor, pasi kërkuesit nuk i është krijuar mundësia për të paraqitur provat e tij në gjykim, duke u vënë në disavantazh të dukshëm me palën kundërshtare.

9.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka parashtruar në pjesën hyrëse të vendimit dhe nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura në shtesën e rekursit, të cilat do të ndikonin në zgjidhjen e çështjes, pasi kishin të bënin me faktin se ajo gjykatë nuk kishte kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes, pasi kjo kompetencë i takonte KPA-së. Në rekurs ishin parashtruar shkaqe me natyrë kushtetuese, sipas parashikimeve të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat i përkisnin juridiksionit të Gjykatës së Lartë. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është kontradiktor, i paqartë, me arsyetim arbitrar dhe argumentet e pjesës arsyetuese nuk lidhen logjikisht me rrethanat e çështjes.

10. ***Subjekti i interesuar, KLGJ-ja***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

10.1. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka qenë kompetent për shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi sipas nenit 140, pika 4, të Kushtetutës, kompetenca për shqyrtimin e masave disiplinore të caktuara nga KLGJ-ja i ka kaluar Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 179, pika 7, të Kushtetutës, KPA-ja shqyrton ankimet ndaj vendimeve të KLGJ-së, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë Gjyqësor për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë. I njëjti përcaktim gjendet edhe në nenin 5, pika 3, të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, kjo kompetencë është përcaktuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 36, datë 24.11.2022, si dhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës të Lartë me vendimin nr. 1, datë 20.1.2023. Në këtë këndvështrim pretendimet e kërkuesit janë të bazuara dhe ato duhet të pranohen.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

14. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 7.3.2023, me të cilin është njohur me anë të postës elektronike nga sekretaria e asaj gjykate në datën 27.3.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 13.7.2023, pra brenda afatit 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin *e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike*, për shkak se

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk kishte kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes së tij dhe se kjo kompetencë i takonte KPA-së, si dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka parashtruar në pjesën hyrëse dhe nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura me shtesën e rekursit. Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtyre pretendimeve, për sa kohë që ato bazohen në mungesën e kompetencës lëndore të gjykatës që ka shqyrtuar mosmarrëveshjen e kërkuesit, vlerëson t'i trajtojë në këndvështrim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për proces të rregullt në aspektet e *së drejtës së aksesit, të ankimit, asaj për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive, si edhe parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* për shkak se ai nuk është njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit me anë të postës elektronike, pavarësisht se kishte lënë të dhënat e tij të kontaktit. Edhe për sa u përket këtyre pretendimeve, bazuar në natyrën dhe thelbin e tyre, Gjykata vlerëson t'i shqyrtojë në këndvështrim të së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar.

16. Për sa më sipër, në kushtet që këto pretendime të kërkuesit janë me natyrë kushtetuese, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata, në vijim, do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

17. Kërkuesi ka pretenduar se sipas nenit 179, pika 7, fjalia e dytë, të Kushtetutës dhe nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, kompetenca për të marrë në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të vendosjes së masave disiplinore të KLGJ-së ndaj gjyqtarëve është KPA-ja. Sipas kërkuesit, të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 36, datë 24.11.2022 dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 1, datë 20.1.2023. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet ta dërgonte çështjen për shqyrtim te KPA-ja, e cila ka juridiksion fillestar për shqyrtimin e këtyre çështjeve. Kërkuesi ka pretenduar se edhe pse në shtesën e rekursit ai ka ngritur pretendime që lidhen me mungesën e kompetencës lëndore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të tilla që do të ndikonin në zgjidhjen e çështjes, ato nuk janë parashtruar në pjesën hyrëse të vendimit dhe nuk janë marrë në shqyrtim. Sipas kërkuesit, vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është kontradiktor, i paqartë, me arsyetim arbitrar dhe argumentet e pjesës arsyetuese nuk lidhen logjikisht me rrethanat e çështjes.

18. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me kërkuesin, duke parashtruar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka qenë kompetent për shqyrtimin e rekursit, pasi sipas nenit 140, pika 4, të Kushtetutës kompetenca për shqyrtimin e masave disiplinore të caktuara nga KLGJ-ja i ka kaluar Gjykatës Kushtetuese. Sipas KLGJ-së, bazuar në nenin 179, pika 7, të Kushtetutës, parashikim që gjendet edhe në ligjin nr. 84/2016, KPA-ja shqyrton ankimet ndaj vendimeve të KLGJ-së, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë Gjyqësor për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë. Sipas këtij subjekti, kjo kompetencë është përcaktuar edhe nga vetë Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, ashtu dhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës të Lartë.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj". Ky element në sensin material, karakterizohet, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Një nga elementet e "gjykatës së caktuar me ligj" është edhe kompetenca lëndore e gjykatës, e cila me ligj është kriter përcaktues i gjykatës që do të vendosë për çështjen dhe i procedurës gjyqësore që do të ndjekë gjykimi konkret. Në përputhje me këtë parim, ligji ka parashikuar verifikimin e kompeten-

cës lëndore për shqyrtimin e çështjes me kërkesë të palëve ose me nismë të vetë gjykatës së cilës i paraqitet kërkesëpadia, pra nëse ajo është kompetente në lëndë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur. Thelbësore në përcaktimin e kompetencës lëndore është identifikimi i natyrës së mosmarrëveshjes, konkretisht objekti dhe shkaku ligjor i saj. Këtij rregulli i nënshtrohen gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat duhet të zbatojnë përcaktimet ligjore materiale dhe procedurale për organizimin dhe funksionimin e tyre *(shih vendimin nr. 3, datë 7.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga kërkuesi ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, që ka shqyrtuar ankimin/ kërkesëpadinë e tij kundër vendimit nr. 99, datë 16.7.2014 të KLD-së, me të cilin ndaj kërkuesit është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim". Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson të shqyrtojë në vijim, në kuptim të kuadrit ligjor të zbatueshëm në rastin konkret, çështjen e kompetencës lëndore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit.

22. Gjykata konstaton se Kushtetuta (përpara ndryshimeve me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar), në nenin 141, pika 1, parashikonte se Gjykata e Lartë kishte juridiksion fillestar dhe rishikues, kurse në nenin 147, pika 6, fjalia e fundit parashikonte se vendimet e KLD-së për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit ankimoheshin në Gjykatën e Lartë, e cila vendoste me Kolegje të Bashkuara. Ky parashikim kushtetues ka gjetur reflektim edhe në përmbajtjen e nenit 34 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" dhe të nenit 36, pika 1, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 9877/2008),* sipas të cilave ndaj vendimit të shkarkimit nga detyra gjyqtari kishte të drejtë të ankohej në Gjykatën e Lartë, e cila vendoste me Kolegje të Bashkuara. Kurse për masat e tjera disiplinore pika 2 e nenit 36 të ligjit nr. 9877/2008 parashikonte se ankimi bëhej në Gjykatën e Apelit Tiranë.

23. Ndërkohë, në datën 3.5.2012 ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 49/2012 dhe me dekretin nr. 8349, datë 14.10.2013 të Presidentit të Republi-kës funksionimi i gjykatave administrative ka filluar në datën 4.11.2013, që është dhe momenti kur ky ligj ka filluar të zbatohet. Në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 është përcaktuar kompetenca lëndore e gjykatës administrative, duke përfshirë në të edhe mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik (pika 1, shkronja "a"). Çështja e kompetencës lëndore të gjykatave administrative është bërë objekt trajtimi edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat, me vendimin unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, kanë arritur në përfundimin se duke filluar nga data 4.11.2013, gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatat e apeleve dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk kanë kompetencë lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, kompetencë që u ka kaluar gjykatave administrative të krijuara sipas ligjit të posaçëm nr. 49/2012.

24. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 është riformuluar edhe neni 140 i Kushtetutës, i cili në pikën 4 ka përcaktuar se kundër vendimit të shkarkimit gjyqtari mund të bëjë ankim në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregullim kushtetues është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit Gjykata shqyrton përfundimisht ankimet kundër vendimeve të KLGJ-së sipas nenit 140, pika 4, të Kushtetutës, dispozitë e cila i referohet vetëm vendimit për shkarkimin e gjyqtarit. Ndërkohë, për një periudhë kalimtare 9-vjeçare kjo kompetencë i ka kaluar KPA-së, sipas nenit 179, pika 7, fjalia e dytë, të Kushtetutës. Në zbatim të parashikimit kushtetues, neni 5, pika 3, shkronja "b", i ligjit nr. 84/2016 ka parashikuar se KPA-ja, gjatë mandatit të saj, ka juridiksion të shqyrtojë edhe ankimet kundër vendimeve të KLGJ-së për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Nga ana tjetër, neni 141 i Kushtetutës nuk parashikon më juridiksionin fillestar të Gjykatës së Lartë, por vetëm juridiksionin rishikues për shqyrtimin e çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit.

25. Gjykata ka evidentuar se me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, Gjykatës së Lartë i është hequr e drejta për të shqyrtuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet e ngritura mbi ankimet kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve, duke rënë për pasojë edhe kompetenca e saj lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre. Referuar përmbajtjes së dispozitave kushtetuese,

gjatë periudhës kalimtare të ushtrimit të mandatit nga KPA-ja, juridiksioni gjyqësor disiplinor i përket ekskluzivisht kësaj të fundit dhe vetëm në përfundim të këtij mandati kushtetues ky juridiksion do të ushtrohet nga Gjykata *(shih vendimin nr. 36, datë 24.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*. Pas këtij vendimi të Gjykatës, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në një çështje për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të KLD-së, të vëna në lëvizje për ushtrimin e juridiksionit fillestar, kanë vlerësuar se nuk kanë më juridiksion gjyqësor të zakonshëm për shqyrtimin e këtyre lloj çështjesh, pra juridiksion fillestar ndaj masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por ky juridiksion ka kaluar tashmë te KPA-ja, ndaj çështja duhet t'i drejtohet kësaj të fundit si organi kompetent *(shih vendimin nr. 1, datë 20.1.2023, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)*.

26. Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim, e cila ka për objekt të saj kundërshtimin e vendimit nr. 99, datë 16.7.2014 të KLD-së për dhënien e masës disiplinore "*Vërejtje me paralajmërim*" ndaj kërkuesit, gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete ka qenë Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, për shkak të fillimit të funksionimit të gjykatave administrative, ia ka dërguar çështjen për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit. Ndërkohë që Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për ushtrimin e juridiksionit të saj rishikues për kontrollin e vendimmarrjes së gjykatës së apelit në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës dhe nenit 43 të Kushtetutës, si instanca më e lartë gjyqësore për kontrollin e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykata më e ulët.

27. Gjykata, duke vënë theksin në natyrën e mosmarrëveshjes si përcaktuese e juridiksionit gjyqësor në momentin e vënies në lëvizje dhe zhvillimit të procesit gjyqësor, në rastin konkret në shqyrtim arrin në përfundimin se ankimi i kërkuesit ndaj vendimit të KLD-së është shqyrtuar nga gjykata kompetente sipas ligjit të kohës. Për sa kohë që Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së apelit, juridiksioni i saj në rastin konkret është ai rishikues, që është përcaktuar nga mjeti procedural i përdorur nga kërkuesi në përputhje me kompetencat e asaj gjykate sipas nenit 141 të Kushtetutës. Edhe ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 nuk kanë prekur apo ndryshuar juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të dhëna nga gjykatat më të ulëta, në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e ligjit prej tyre. Në këtë kuptim, ushtrimi i këtij juridiksioni nga një gjykatë tjetër, përfshi Gjykatën Kushtetuese apo KPA-në, do të binte ndesh me nenin 141 të Kushtetutës ashtu edhe parimet e shtetit të së drejtës dhe të ndarjes e balancimit të pushteteve, sipas neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës.

28. Gjykata konstaton, gjithashtu, se në shtesën e rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuesi ka parashtruar shkaqe që kanë të bëjnë me gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, që nuk janë pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe nuk kanë marrë përgjigje të shprehur në atë vendim. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë atë gjykim, ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit brenda shkaqeve të ngritura në të nga kërkuesi, duke i dhënë përgjigje atij se nuk përfshihen në ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Gjykata ka vlerësuar se gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt, nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson *(shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se për sa kohë që Gjykata e Lartë e ka gjetur këtë pretendim të pabazuar edhe në thelb, vetëm fakti që ai nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar prej saj nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Për më tepër, fakti që Gjykata e Lartë ka vijuar me shqyrtimin e rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit nënkupton se ajo e ka vlerësuar edhe çështjen e kompetencës e saj në kuptim të juridiksionit rishikues.

29. Për këto arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar

30. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit me anë të postës elektronike, edhe pse ai i kishte lënë të dhënat e tij të kontaktit. Në këtë mënyrë Gjykata e Lartë nuk ka garantuar krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta në gjykim dhe nuk i ka krijuar mundësinë

kërkuesit për të paraqitur provat, duke e vënë në disavantazh të dukshëm me palën kundërshtare.

31. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për gjykimin dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Sipas Gjykatës, kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare *(shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, e drejta për t'u dëgjuar nuk është absolute dhe ajo nuk konsiderohet e cenuar vetëm për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, për sa kohë që individi ka pasur mundësinë që të paraqesë pretendimet e tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, të cilat janë shqyrtuar nga kolegji i asaj gjykate në dhomën e këshillimit dhe, mbi këtë bazë, është vendosur moskalimi i çështjes në seancë gjyqësore *(shih vendimin nr. 14, datë 5.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese)*.

32. Duke iu referuar fakteve të çështjes konkrete në shqyrtim përpara saj, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të kërkuesit, i cili është regjistruar në datën 3.6.2016. Në datën 12.9.2022 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtrime shtesë (shtesë rekursi), ku rezulton që të ketë lënë edhe të dhënat e adresës së tij elektronike. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë rezulton se në datën 15.2.2023 është publikuar lista e çështjeve që do të gjykoheshin në dhomën e këshillimit të datës 7.3.2023, si edhe përbërja e trupit gjykues dhe ora e shqyrtimit të çështjes, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit. Po kështu, sipas akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi rezulton se Gjykata e Lartë ka bërë edhe njoftimin me shpallje në ambientet fizike të saj.

33. Gjykata vëren se në fazën e shqyrtimit paraprak Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje në bazë të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, i cili ka pasur mundësinë të parashtrojë të gjitha pretendimet e tij në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit dhe vendimmarrjen e asaj gjykate dhe, në vijim, edhe në lidhje me juridiksionin e Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes së tij. Për rrjedhojë, nuk provohet që ai të jetë vendosur në pozita të pafavorshme në krahasim me palën tjetër në proces në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar në aspektin substancial. Pavarësisht se kërkuesi nuk është njoftuar edhe përmes adresës së tij elektronike, ai nuk ka arritur të provojë, edhe pse ka barrën e provës në këtë drejtim, se kjo parregullsi procedurale e ka vënë në pamundësi të ushtrojë të drejtat procedurale që i njihen në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes, përfshirë të drejtën për të kundërshtuar përbërjen e trupit gjykues. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar është i pabazuar.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 4.4.2024.
Shpallur më 9.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Elsa Toska, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci
Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Bujar Musta, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-734, datë 7.3.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jemi kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se ajo duhej të ishte pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan deri në momentin që KPK-ja ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Gjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtarit ndaj kërkuesit ka filluar një procedim disiplinor, i cili ka përfunduar me dhënien ndaj tij, nga ish-KLD-ja, të masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim". Ndaj vendimit të ish-KLD-së që ka disponuar për masën disiplinore kërkuesi ka paraqitur kërkesëpadi pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, me objekt shfuqizimin e tij. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 9, datë 15.3.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-734, datë 7.3.2023, ka vendosur mospranimin e tij.

3. Konkretisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka arsyetuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012, duke argumentuar, ndër të tjera, se përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor dhe duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes. Sipas Kolegjit Administrativ vendimi nuk bie ndesh me praktikën e konsoliduar të tij ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale nuk është parashtruar nga rekursuesi në mjetin e tij të ankimit para Gjykatës së Lartë *(shih paragrafin 16 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

4. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual me objekt shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ai ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi, sipas tij, kompetenca për të marrë në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të KLGJ-së (ish-KLD-së) për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve i përket KPA-së dhe jo Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, ai ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për shkak se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka parashtruar në pjesën hyrëse të vendimit dhe nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura në shtesën e rekursit, që kishin të bënin me faktin se ajo gjykatë nuk kishte kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes.

5. Bazuar në këto rrethana të çështjes, shumica ka analizuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit *(shih paragrafin 15).* Në lidhje me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga gjykatë e caktuar me ligj, sipas shumicës, ankimi i kërkuesit ndaj vendimit të KLD-së është shqyrtuar nga gjykata kompetente sipas ligjit të kohës dhe për sa kohë që Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së apelit, juridiksioni i saj në rastin konkret është ai rishikues, në kuptim të neneve 141 dhe 43 të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas shumicës, Gjykata e Lartë, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin në atë gjykatë, ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit brenda shkaqeve të ngritura në të nga kërkuesi, duke i dhënë përgjigje atij se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Në vlerësimin e shumicës, gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson. Në këtë kuptim, shumica ka vlerësuar se për sa kohë që ajo e ka gjetur pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të pabazuar, vetëm fakti që ai nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Për këto arsye, shumica ka çmuar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

gjyqësor është i pabazuar *(shih paragrafët 27–29 të vendimit)*.

6. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtaret në pakicë, çmojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, është i bazuar.

7. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre *(shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese)*.

8. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin në shqyrtim, sikurse konstaton edhe shumica, përpara ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, ankimet ndaj masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, të ndryshme nga ato të shkarkimit nga detyra, (sikurse ka ndodhur në çështjen konkrete) shqyrtoheshin nga gjykata (administrative) e apelit. Ndaj vendimit të kësaj të fundit gjyqtari mund të paraqiste rekurs në Gjykatën e Lartë. Ndërsa pas këtyre ndryshimeve, bazuar në nenin 179, pika 7, të Kushtetutës, kompetenca për shqyrtimin e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve i përket KPA-së për sa kohë që ajo ushtron juridiksionin e saj. Në zbatim të parashikimit kushtetues, neni 5, pika 3, shkronja "b", i ligjit nr. 84/2016 ka parashikuar se KPA-ja, gjatë mandatit të saj, ka juridiksion të shqyrtojë edhe ankimet kundër vendimeve të KLGJ-së për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve (*shih paragrafët 22-24*). Në lidhje me ligjin e ri procedural, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ligji procedural zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe *(shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 3, datë 11.2.2021; nr. 11, datë 23.4.2009, të Gjykatës Kushtetuese)*.

10. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.6.2016, pra përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese. Gjithashtu, konstatohet se në datën 12.9.2022, kërkuesi ka paraqitur parashtrime shtesë (shtesë rekursi), në përmbajtje të të cilave ka pretenduar se bazuar në nenin 5, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr. 84/2016, kompetente për shqyrtimin e rekursit së tij është KPA-ja dhe jo Gjykata e Lartë dhe se kjo e fundit duhet ta marrë në konsideratë këtë kërkesë të tij (*shih paragrafin 4 të faqes së katërt të parashtrimeve shtesë të rekursit*). Rekursi është marrë në shqyrtim në datën 7.3.2023, megjithatë nuk rezulton se pretendimi i kërkuesit të jetë pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ku parashtrohen pretendimet e rekursuesit (*shih faqen 5–6 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*), si dhe të jetë shqyrtuar ose t'i jetë dhënë përgjigje nga ai kolegj.

11. Nën dritën e standardeve kushtetuese dhe rrethanave të çështjes konkrete vlerësojmë se ndonëse arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit të rekursit nuk përbën në vetvete shkelje kushtetuese, Gjykata e Lartë, duke qenë se

çështja e kompetencës lëndore merret në shqyrtim edhe kryesisht, duhet t'i kishte dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj lidhur me kompetencën e saj për shqyrtimin e rekursit, për shkak të natyrës kushtetuese të tij. Për më tepër, siç ka rezultuar nga rrethanat, kërkuesi në rekurs ka parashtruar argumente në lidhje me shqyrtimin e çështjes së tij nga KPA-ja ose Gjykata e Lartë, duke lënë të nënkuptuar që kompetente për shqyrtimin e çështjes së tij mund të ishte KPA-ja.

12. Në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë si gjykatë ligji dhe bazuar në parimin e subsidiaritetit, nisur nga parashikimet e dispozitave aktuale në fuqi, duhet të arsyetonte për të përcaktuar në mënyrë të qartë se kujt i përket kompetenca lëndore në lidhje me masat disiplinore të ndryshme nga ato të shkarkimit nga detyra, të cilat sipas dispozitave të kohës janë kundërshtuar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe për të cilat këto të fundit janë shprehur me vendim ndaj të cilit është bërë rekurs. Kjo nevojë për një arsyetim më të plotë diktohet edhe nga fakti se si nga Gjykata, ashtu dhe Gjykata e Lartë nuk ka një qëndrim të shprehur për këto raste. Ndërkohë për sa i takon masës disiplinore të shkarkimit të gjyqtarëve, vetë Gjykata e Lartë, bazuar në vendimin e Gjykatës nr. 36, datë 24.11.2022, me vendimin e saj unifikues nr. 1, datë 20.1.2023, është shprehur se nuk ka më juridiksion gjyqësor të zakonshëm për shqyrtimin e këtyre lloj çështjesh, pra për ushtrimin e juridiksionit fillestar ndaj masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por ky juridiksion ka kaluar tashmë te KPA-ja.

13. Për sa më lart, ne, gjyqtaret në pakicë, duke konsideruar parashikimet e dispozitave në fuqi në lidhje me ankimin ndaj masave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe në përputhje me parimin *tempus regit processum,* vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk duket i pabazuar, prandaj arrijmë në përfundimin se Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte atë dhe t'i jepte përgjigje të arsyetuar.

14. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtaret në pakicë, çmojmë se pretendimet e paraqitura nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual janë të bazuara, ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës.

Anëtarë: Marjana Semini, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji

VENDIM
Nr. 27, datë 11.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahimi	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.4.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (J) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Julian Çela

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria "Alb-Edilizia" sh.p.k., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 23/8, datë 19.1.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "Alb-Edilizia" sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Julian Çela ka qenë i punësuar pranë shoqërisë "Alb-Edilizia" sh.p.k. në pozicionin e juristit, në bazë të kontratës së punës të datës 1.11.2013. Për shkak të një shpërthimi me eksploziv, të ndodhur në datën 26.2.2014, në ambientet e punëdhënësit kërkuesi është dëmtuar rëndë, duke humbur të dyja anësitë inferiore. Për këtë arsye ai u është nënshtruar ndërhyrjeve dhe trajtimeve spitalore dhe farmaceutike. Në lidhje me këtë ngjarje Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 1628, të vitit 2014, për dyshime për veprën penale "Vrasja e mbetur në tentativë në rrethana të cilësuara", të parashikuar nga neni 79/dh i Kodit Penal. Duke pretenduar se dëmtimi i tij ka ndodhur në ambientet e punës dhe se punëdhënësi nuk i ka ofruar asnjë ndihmë për të përballuar shpenzimet për mjekimin dhe ato për trajtimin e tij, në dhjetor të vitit 2015 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt detyrimin e palës së paditur, shoqërisë "Alb-Edilizia" sh.p.k., t'i paguajë dëmin real pasuror dhe jopasuror, biologjik, moral dhe ekzistencial, shpenzimet farmaceutike dhe spitalore, si dhe shpenzimet e avokatit. Mbi këtë kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar çështja nr. 15007/4501 akti, datë 18.12.2015.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5485, datë 24.6.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se asnjë veprim i kryer nga shoqëria nuk i ka shkaktuar dëm paditësit (kërkuesit) dhe se nuk u provua se pasoja e ardhur ka lidhje me veprimet të drejtpërdrejta dhe me faj të palës së paditur. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 96, datë 24.1.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se paditësi (kërkuesi) nuk ka provuar se i padituri është përgjegjës për dëmin e ardhur dhe për sa kohë nuk provohet veprimi apo mosveprimi i kryer me faj nga i padituri mungon edhe lidhja shkakësore, ndaj padia nuk mund të pranohet. Kundër këtij vendimi në datën 19.3.2018 kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, mbi bazën e të cilit është regjistruar çështja nr. 11243-02058-00-2018, datë regjistrimi 9.7.2018.

4. Në datën 9.12.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes së tij, pasi që nga momenti i regjistrimit të kësaj çështjeje kishte kaluar një periudhë kohë prej 4 vjetësh dhe 6 muajsh, çka përbënte shkelje të afatit 2-vjeçar të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka kërkuar mendim nga gjyqtari relator, me vendimin nr. 23/8, datë 19.1.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Kolegji Penal, në vlerësim të standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) për afatin e arsyeshëm, ka vlerësuar se çështja nuk paraqitet komplekse dhe nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit. Në lidhje me mosveprimin e gjykatës Kolegji Penal ka vlerësuar se duhet mbajtur në konsideratë stoku i madh i çështjeve të akumuluara dhe ngarkesa totale e gjyqtarit relator dhe se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që e kalon rastin konkret. Sipas tij, mosveprimi në këtë rast nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar edhe kritere transparente për shqyrtimin e çështjeve sipas radhës së vjetërsisë së tyre (*shih paragrafët 17, 18 dhe 22 të vendimit të Kolegjit Penal*).

6. Në datën 22.6.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 26.7.2023. Në datën 30.10.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 7.11.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. Kërkuesi, ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimmarrja e kundërshtuar e Gjykatës së Lartë i ka cenuar:

7.1 Të drejtën për proces të rregullt në drejtim të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e paanshme, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi Kolegji Penal, ndonëse pranon se rekursi është regjistruar në atë gjykatë në datën 9.7.2018 dhe ende nuk është shqyrtuar, ka vlerësuar kriterin e shqyrtimit të çështjeve në rend kronologjik si të arsyeshëm dhe që siguron barazinë e të gjitha palëve përkundër detyrimeve të parashikuara në ligj. Një arsyetim i tillë nuk mund të pranohet, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit procedural që parashikojnë gjykatën kompetente dhe afatin e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Vendimi i kundërshtuar e bën arbitrar qëndrimin e Gjykatës së Lartë, duke i mohuar kërkuesit të drejtën për të kërkuar shpërblim të drejtë dhe duke mos i caktuar një datë për gjykimin e çështjes së tij.

7.2 Të drejtën për t'u zhdëmtuar në përputhje me ligjin, të parashikuar nga neni 44 i Kushtetutës, për sa kohë që e drejta për shpërblim të drejtë, në kuptim të neneve 399/3, 399/4, pika 2 dhe 399/6, pikat 2 dhe 3, të KPC-së, i lind kërkuesit pasi të pajiset me një vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe për përshpejtimin e procesit gjyqësor.

***8. Subjekti i interesuar*, shoqëria "Alb-Edilizia" sh.p.k.** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për të cilin ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

11. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Gjykata vëren se pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ajo ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të investohej drejtpërdrejt për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij të regjistruar në atë gjykatë, për të cilën Kolegji Penal, me vendimin nr. 23/8, datë 19.1.2023, ka vendosur rrëzimin e saj. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

13. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis* Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 19.1.2023, kurse kërkesa është paraqitur Gjykatë në datën 20.6.2023. Sipas kërkuesit, ai është njohur me vendimin në datën 3.3.2023 përmes shërbimit postar. Për të provuar

këtë pretendim ai ka paraqitur bashkëlidhur kërkesës zarfin e komunikimit të vendimit të kundërshtuar, në të cilin rezulton vula e Gjykatës së Lartë, ku ndodhet shënimi "*23/8*", si dhe vula e zyrës postare që i korrespondon datës 27.2.2023. Me shkresën nr. 5013/1 prot., datë 18.10.2023, Gjykata e Lartë, në përgjigje të kërkesës së Gjykatës, ka dërguar kopje të akteve të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. 23/8, datë 19.1.2023, ku rezulton edhe kopje e dëftesës së komunikimit të këtij vendimi drejtuar avokatit të kërkuesit. Duke konsideruar datën e njoftimit shkresor të vendimit si datën në të cilën kërkuesi është njohur efektivisht me vendimin, si edhe duke pasur parasysh se jemi para një shkeljeje vazhduese, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuesit të regjistruar në Gjykatën e Lartë, për të cilën ende nuk ka një vendimmarrje dhe as një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj. Kërkuesi ka pretenduar se qëndrimi i Kolegjit Penal që ka vendosur rrëzimin e kërkesës nuk është i drejtë dhe ka interpretuar gabim dispozitat procedurale, për rrjedhojë i ka cenuar edhe të drejtën për të përfituar shpërblim të drejtë dhe për të pasur një datë të gjykimit të çështjes së tij. Për rrjedhojë, Gjykata do t'i vlerësojë pretendimet e kërkuesit vetëm në këndvështrim të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor të kundërshtuar, të cilat, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

15. Sipas kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndonëse pranon se rekursi është regjistruar në atë gjykatë në datën 9.7.2018 dhe ende nuk është shqyrtuar, ka vlerësuar kriterin e shqyrtimit të çështjeve në rend kronologjik si të arsyeshëm dhe që siguron barazinë e të gjitha palëve përkundër detyrimeve të parashikuara në ligj. Po sipas tij, një arsyetim i tillë nuk mund të pranohet, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit procedural që parashikojnë gjykatën kompetente dhe afatin e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Sipas kërkuesit, vendimi i kundërshtuar e bën arbitrar qëndrimin e Gjykatës së Lartë, duke i mohuar atij të drejtën për të kërkuar shpërblimin e drejtë dhe duke mos i caktuar një datë për gjykimin e çështjes së tij. Sipas tij, kjo e drejtë i lind pasi të pajiset me një vendim të formës së prerë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procesit gjyqësor.

16. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e punëdhënësit të tij (subjektit të interesuar) t'i paguajë dëmin real pasuror dhe jopasuror, biologjik, moral dhe ekzistencial, shpenzimet farmaceutike dhe spitalore për shkak të dëmtimeve të pësuara në vendin e punës, si dhe shpenzimet e avokatit. Kjo çështje është regjistruar në atë gjykatë në datën 18.12.2015 dhe me vendimin nr. 5485, datë 24.6.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Mbi ankimin e kërkuesit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 96, datë 24.1.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Mbi bazën e rekursit të kërkuesit në Gjykatën e Lartë është regjistruar çështja nr. 11243-02058-00-2018, datë regjistrimi 9.7.2018 dhe sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të asaj gjykate ajo rezulton me statusin "*në proces*", pra për të nuk ka ende një vendimmarrje. Gjykata vlerëson të theksojë se në rastin konkret, duke pasur parasysh se pretendimet e kërkuesit në ankimin kushtetues kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e shqyrtimit të rekursit të tij në Gjykatën e Lartë, i cili është në pritje të shqyrtimit prej më shumë se 5 vjetësh, ajo do të ndalet vetëm në vlerësimin e kohëzgjatjes së këtij procesi.

18. Gjykata vëren se me ndryshimet e KPC-së të vitit 2017, në parashikimet ligjore për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ligjvënësi ka përcaktuar

afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë, që zgjatet edhe me 1 vit e 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (neni 109, i ligjit nr. 38/2017), siç është edhe çështja e kërkuesit. Gjykata, duke iu referuar kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë konstaton se në atë shkallë të gjykimit është tejkaluar afati i parashikuar për këtë lloj gjykimi nga KPC-ja.

19. Gjykata ka konstatuar tashmë, në parim, gjatë shqyrtimit të çështjeve që lidhen me kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit, se vonesat janë pasojë e ngarkesës së lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Gjykata ka pohuar edhe se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht *(shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke zgjatur prej disa vitesh prandaj dhe metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1–399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 61, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në vështrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkuesit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Në lidhje me *sjelljen e kërkuesit* Gjykata vëren se ai është pala që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor për të cilin ka kërkuar kohëzgjatjen e paarsyeshme. Pasi është njohur me vendimet e gjykatave të zakonshme që kanë rrëzuar kërkesëpadinë, kërkuesi i ka kundërshtuar ato në gjykatat më të larta, duke shteruar mjetet e zakonshme të ankimit që u njihen palëve në procesin gjyqësor nga legjislacioni procedural civil. Pasi çështja e tij është regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe është në pritje të planifikimit të datës për shqyrtimin e rekursit, kërkuesi i është drejtuar po asaj gjykate me kërkesën e datës 9.12.2022, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Pasi është njohur me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkese, ai ka paraqitur ankim kushtetues individual me të njëjtin objekt.

22. Gjykata vëren se edhe Kolegji Penal, në vendimin e tij, referuar elementeve të përcaktuara nga praktika e GJEDNJ-së në lidhje me standardin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, ka vlerësuar se çështja nuk rezulton të jetë pezulluar ose shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese dhe nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga momenti i regjistrimit në Gjykatën e Lartë nuk është kryer asnjë veprim (*shih paragrafin 17 të vendimit të Kolegjit Penal*). Për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

23. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes* Gjykata vlerëson të theksojë qëndrimin se ai nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i çështjes dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme. Në këtë kuptim, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera të gjykimit (*shih vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me çështjen konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të faktit, të cilat kanë vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur prej tij për detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë dëmin real pasuror dhe jopasuror, biologjik, moral dhe ekzistencial, si dhe shpenzimet farmaceutike dhe spitalore, me arsyetimin se nuk

është provuar asnjë veprim i kryer nga shoqëria që t'i ketë shkaktuar dëm paditësit (kërkuesit), pra pasoja të ardhura nga veprime të drejtpërdrejta dhe me faj të palës së paditur. Për rrjedhojë, nga aktet e administruara nga Gjykata për nevoja të këtij gjykimi, nuk konstatohet që çështja të paraqesë, në dukje, ndonjë kompleksitet që të justifikojë kohëzgjatjen e saj. Gjykata vëren se edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, referuar elementeve që përcaktojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, ka vlerësuar se çështja konkrete nuk paraqitet shumë komplekse për nga natyra e saj (*shih paragrafin 17 të vendimit të Kolegjit Penal*).

24. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve,* duke mbajtur në konsideratë sa është theksuar më sipër për situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor (*shih paragrafin 19 të vendimit*), Gjykata vëren, referuar rrethanave të çështjes konkrete, se çështja e kërkuesit është në shqyrtim në Gjykatën e Lartë prej më shumë se 5 vjetësh pa një vendimmarrje të asaj gjykate. Gjykata e Lartë, për sa i përket kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, ka vlerësuar se është në pamundësi objektive të përshpejtojë gjykimin. Edhe pse ajo ka analizuar në vendim elementet e standardit kushtetues të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, argumenti kryesor, i cili qëndron në thelb të vendimit, lidhet me pamundësinë objektive të gjyqtarit, të shkaktuar nga efektet e zbatimit të reformës, për shkak të volumit të lartë të çështjeve që ka në shqyrtim, ndërkohë që ai është duke zbatuar kriterin e radhës së vjetërsisë së çështjeve të caktuara në cilësinë e gjyqtarit relator. Në analizë të të dhënave të mësipërme, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit lidhet me ngarkesën e lartë në Gjykatën e Lartë dhe të gjyqtarit relator, të shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

25. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi,* Gjykata, në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, ka vlerësuar se për disa çështje ka interes veçanërisht të lartë nisur nga interesi i kërkuesit, mes të tjerash edhe për procedurat e kompensimit për dëmtime të shëndetit. Gjykata, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, vëren se kërkuesi për shkak të dëmtimeve të pësuara ka marrë statusin e personit me aftësi të kufizuara. Po kështu, referuar thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata vëren se kërkuesi e ka lidhur të drejtën e tij, në thelb, me zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga dëmtimet fizike të pësuara gjatë ushtrimit të detyrës pranë palës së paditur (punëdhënësit). Edhe pse çështja e kërkuesit, për nga natyra e saj, nuk përfshihet në kategorinë e çështjeve që Gjykata e Lartë ka përcaktuar se duhet të shqyrtohen me përparësi, duke pasur parasysh jo vetëm statusin e kërkuesit si person me aftësi të kufizuara, por edhe interesin e tij të lartë vetjak për shkak të natyrës së kësaj çështjeje, si edhe referuar faktit se Gjykata e Lartë nuk ka ndërmarrë ende ndonjë veprim për caktimin e datës së shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, Gjykata vlerëson se kjo çështje duhet të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit të saj.

26. Për sa më sipër, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej kritereve të mësipërme që janë përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, Gjykata çmon se në rrethanat e rastit konkret, në kuptim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata e Lartë ka tejkaluar kufirin kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues, prandaj kërkesa pranohet.

27. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon se kjo çështje duhet të shqyrtohet me përparësi nga Gjykata e Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 23/8, datë 19.1.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë.

4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë për të gjykuar çështjen gjyqësore nr. 11243-02058-00-2018 me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.4.2024.
Shpallur më 9.5.2024.

Kryetare (kundër): Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini
Anëtar kundër: Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 2 (J) 2023 të Regjistrit Themeltar që i përket kërkuesit Julian Çela, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit nr. 23/8, datë 19.1.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar për shkak se në drejtim të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit gjyqësor të kundërshtuar nuk është plotësuar kriteri i rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi. Për këtë arsye, çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim, siç ka konstatuar edhe shumica, në rastin konkret procesi i kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë, ku rekursi i paraqitur prej tij është në pritje të shqyrtimit të tij edhe pse ka kaluar një periudhë kohore prej më shumë se 5 vjetësh, është në tejkalim të afatit të parashikuar për këtë lloj gjykimi nga KPC-ja. Megjithatë, kjo, në vetvete, nuk përbën argument për të deklaruar kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit, për sa kohë që për të arritur në një vlerësim të tillë nevojitet të vlerësohen kriteret e përcaktuara në jurisprudencën kushtetuese, në përputhje me atë të GJEDNJ-së, konkretisht ato që kanë të bëjnë me: i. sjelljen e kërkuesit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi.

3. Për sa u përket tre kritereve të para, bashkohemi me shumicën në vlerësimin që ajo i ka bërë sjelljes së kërkuesit dhe asaj të autoriteteve, si edhe kompleksitetit të çështjes. Megjithatë, ne ndahemi nga qëndrimi i shumicës në lidhje me kriterin e katërt, pra atë të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi nga kohëzgjatja e procesit të kundërshtuar.

4. Sipas shumicës, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, kërkuesi për shkak të dëmtimeve të pësuara ka marrë statusin e personit me aftësi të kufizuara. Po kështu, referuar thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, ai e ka lidhur të drejtën e tij, në thelb, me zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga dëmtimet fizike të pësuara gjatë ushtrimit të detyrës pranë palës së paditur (punëdhënësit). Po sipas shumicës, edhe pse çështja e kërkuesit, për nga natyra e saj, nuk përfshihet në kategorinë e çështjeve që Gjykata e Lartë ka përcaktuar se duhet të shqyrtohen me përparësi, duke pasur parasysh jo vetëm statusin e kërkuesit si person me aftësi të kufizuara, por edhe interesin e tij të lartë vetjak për shkak të natyrës së kësaj çështjeje, si edhe referuar faktit se Gjykata e Lartë nuk ka ndërmarrë ende ndonjë veprim për caktimin e datës së shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, kjo çështje duhet të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit të saj (*shih paragrafin 25 të vendimit*).Gjykata ka theksuar se kriteri rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Megjithatë, Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit dhe në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuesin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë", siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës, duhet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë gjykimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim është theksuar se disa çështje kanë interes veçanërisht të lartë nisur nga interesi i kërkuesit, të tilla si: mosmarrëveshjet familjare; vërtetimi i amësisë ose atësisë; viktimat e aksidenteve rrugore, të dhunës penale ose dhunës policore; punësimi ose sigurimet shoqërore; heqja e lejes për të ushtruar profesionin; qëndrimi i të akuzuarve në paraburgim; çështjet e personave që vuajnë nga sëmundje të pashërueshme; procedurat e kompensimit për dëmtime të shëndetit, në veçanti kur ekziston mundësia që kërkuesi të ndërrojë jetë deri në përfundim të procedurave; mosmarrëveshjet

familjare për fëmijët; statusin martesor dhe heqjen ose rivendosjen e aftësisë juridike; çështjet e vëna në lëvizje nga të burgosurit për kushte të burgimit, të tilla që cenojnë nenin 3 të KEDNJ-së, të cilat janë edhe më urgjente *(shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

5. Në kuptim të sa më sipër, vlerësojmë se natyra e çështjes, në vetvete, nuk është e mjaftueshme për të përcaktuar interesin e lartë vetjak të personit që kërkon përshpejtimin e procedurave, por është e nevojshme edhe të provuarit të këtij interesi në drejtim të pasojave të ardhura apo të mundshme për shkak të asaj vonese. Duke pasur parasysh këto elemente, vërejmë se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente dhe as ka paraqitur prova në drejtim të asaj çfarë rrezikon për shkak të vonesës së procedurave të shqyrtimit të rekursit të tij nga Gjykata e Lartë.

6. Në drejtim të interesit dhe rrezikut të kërkuesit, duhet pasur parasysh dhe juridiksioni dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, sikundër edhe fakti se gjykatat e faktit kanë vendosur rrëzimin e padisë së tij, duke vlerësuar se nuk është provuar që dëmtimet e shkaktuara kërkuesit në vendin e tij të punës të kenë ardhur si pasojë e veprimeve të drejtpërdrejta dhe me faj të punëdhënësit të paditur. Po kështu, merr rëndësi edhe fakti se kërkuesi nuk ka një vendim gjyqësor që t'i ketë njohur atij të drejtën për dëmshpërblim nga pala e paditur, ndaj nuk mund të arrihet në përfundimin se vonesa në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë krijon për atë implikime në lidhje me përfitimin në kohë të masës së dëmshpërblimit.

7. Në vlerësimin tonë si gjyqtarë në pakicë, në drejtim të kriterit të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi për shkak të vonesës së Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e rekursit të tij, në kontekst të rrethanave të rastit, ai nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij "vetjakë e jetësorë", të cilat kërkojnë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij.

8. Për sa më sipër, duke pasur parasysh kriteret që shqyrtohen për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, në rastin konkret, në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi, mbajtëm qëndrimin se nuk ka cenim të së drejtës për proces të rregullt në aspekt të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, ndaj kërkesa duhej të ishte rrëzuar.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtar: Ilir Toska

NJOFTIM
Nr. 7233, datë 8.5.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë për Mbrojtjen Shoqërore, nënshkruar më datë 2 tetor 2023, ka hyrë në fuqi më datë 1 maj 2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

NJOFTIM
Nr. 7234, datë 8.5.2024

PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja në lidhje me Programin e Shkëmbimit të Studimeve Universitare në Evropën Qendrore ("CEEPUS IV"), bërë në Varshavë, më 20.9.2023, hyn në fuqi për Republikën e Shqipërisë më 1.5.2025 dhe është e vlefshme për një periudhë 7-vjeçare.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 29, datë 8.5.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR KRAHASUESHMËRINË E TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESAVE DHE PËR SHËRBIMIN E TRANSFERIMIT TË LLOGARIVE TË PAGESAVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja "e", të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave"; dhe të nenit 8, pika 3, nenit 14 dhe nenit 22 të ligjit nr. 100/2023, datë 14.12.2023, "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike"; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 21.12.2022, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 1 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"*Objekti i kësaj rregulloreje është:*

a) përcaktimi i kërkesave për krahasueshmërinë dhe transparencën e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të pagesave dhe i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave;

b) përcaktimi i kërkesave për krahasueshmërinë dhe transparencën e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të pagesave me shërbime bazike dhe i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave me shërbime bazike ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave; si dhe

c) përcaktimi i metodologjisë së përllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike.";

b) Në nenin 2, pas togfjalëshit *"ligjit nr. 55/2020 "Për shërbimet e pagesave""*, shtohet togfjalëshi *", si dhe bankat dhe degët e bankave të huaja, sipas ligjit nr. 100/2023 "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike""*;

c) Neni 3, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"*Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja "e", të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji "Për bankat"); të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave" (më poshtë ligji "Për shërbimet e pagesave") dhe të nenit 8, pika 3, nenit 14 dhe nenit 22 të ligjit nr. 100/2023, datë 14.12.2023, "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike" (më poshtë ligji "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike").*";

d) Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

i. Pika 1, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"*1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 4 të ligjit "Për bankat", nenit 5 të ligjit "Për shërbimet e pagesave" dhe nenit 5 të ligjit "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike".*";

ii. në pikën 2, pas shkronjës *"a"*, shtohet shkronja *"a/1"* me përmbajtjen e mëposhtme:

"a/1) "llogari e pagesave me shërbime bazike" - do të ketë të njëjtin kuptim si në ligjin "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike";";

iii. në pikën 2, shkronja "h", togfjalëshi *"në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar"*, zëvendësohet me togfjalëshin *"në pikën 18 të nenit 5 të ligjit "Për shërbimet e pagesave"."*;

e) Pas nenit 16, shtohet "KREU IV" dhe nenet 17 dhe 18 si pjesë përbërëse e kreut IV, me përmbajtjen e mëposhtme:

"KREU IV
KËRKESA PËR LLOGARINË E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE

Neni 17
Krahasueshmëria, transparenca e tarifave dhe transferimi i llogarive të pagesave me shërbime bazike

Kërkesat e kreut I, II dhe III të kësaj rregulloreje për llogarinë e pagesave, zbatohen në të njëjtën mënyrë nga bankat, edhe për llogarinë e pagesave me shërbime bazike, në zbatim

të kërkesave të nenit 14 të ligjit "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike".

Neni 18

Metodologjia e përllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike

Bankat, në përllogaritjen e tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike, siç parashikohet në nenin 8, pika 3 të ligjit "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike", bazohen në nivelin mesatar të tarifës së aplikuar nga banka, për të njëjtat shërbime të ofruara nëpërmjet një llogarie pagesash dhe në çdo rast tarifa e arsyeshme nuk tejkalon 50% të këtij niveli mesatar.";

f) Kreu IV "Dispozita të fundit", rinumërtohet si kreu V;

g) Neni 17 dhe neni 18, rinumërtohen përkatësisht si neni 19 dhe neni 20;

h) Në nenin 19 të rinumërtuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. titulli i nenit *"Ankesat e klientëve",* zëvendësohet me titullin *"Ankesat e konsumatorëve"*;

ii. pas togfjalëshit *"për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve"*, shtohet togfjalëshi *", përfshirë edhe ankesat në lidhje me llogarinë e pagesave me shërbime bazike."*;

i) Në nenin 20 të rinumërtuar, pas togfjalëshit *"në ligjin "Për shërbimet e pagesave""*, shtohet togfjalëshi *", në ligjin "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike""*.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

KËRKESË

Shtetasi Rakip Doda, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetases Mereme Doda, e bija e Estref dhe Hajrie, e datëlindjes 13.4.1969, lindur në Tiranë dhe me vendbanim në Lezhë.

KËRKUES
Rakip Doda

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/05/14 15:08:55 +02'00'
ae3fda73952941a2863d8c6c6665e7f0202405141
5084653031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)